



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/Ministarstvo Obrazovanja i Nauke, Tehnologije i Inovacija /Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Kabineti i Ministres/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Numër: OIB/328
Datë: 12. 11. 2021

Ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të neneve 8, 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06 / L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta zyrtare nr. 7/01 mars 2019), duke u mbështetur në vendimin me nr. 62/2021 të dt. 11.10.2021 të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve dhe Memorandumit të bashkëpunimit të nënshkruar me dt. 12 tetor 2021, neni 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4, shtojca 1 paragrafi 7 i Rregullores (QRK) nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive të datës 30. 03. 2021 nxjerr:

V E N D I M

**Për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve
për subvencionimin e maturantëve për ndjekjen e kurseve në fushën e teknologjisë informative**

1. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, ndajnë kuponë për kurse të trajnimit në fushën e teknologjisë informative për zbatimin e pjesëshëm të masës 1.5 të pakos së Ringjalljes Ekonomike.
2. Kuponët për kurset në fushën e TI do t'iu ndahen 2000 (dy mijë) maturantëve të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara.
3. Vlera e kuponit është 600 euro (gjashtëqind euro) dhe do të ndahet si në vijim:
 - 3.1. Shuma prej 200 euro (dyqind euro) ndahet për mbulimin e shpenzimeve indirekte (transporti, ushqimi).
 - 3.2. Shuma prej 300 euro (treqind euro) ndahet për rimbursimin e shpenzimeve direkte (pagesa për regjistrimin e kursit).
 - 3.3. Shuma prej 100 euro (njëqind euro) ekzekutohet pas përfundimit me sukses të trajnimit dhe marrjes së certifikatës.
4. Maturantët përfitues të këtyre kuponëve do të për zgjedhin individualisht programin e trajnimit në fushën e TI dhe institucionin i cili ofron trajnimin me kusht që ofruesit e trajnimit të kenë programin e akredituar.

5. Kuotat për përfituesit e kuponëve do të ndahen proporcionalisht sipas numrit të nxënësve për shkollat e mesme të larta profesionale dhe gjimnaze në nivel shkolle.
6. Në komunat – shkollat ku ka maturantë të komuniteteve joshumicë, të njëjtit mund të përfitojnë deri në 10% të kuponëve në nivel shkolle.
7. Në komunat – shkollat ku ka nxënës me nevoja të veçanta, të njëjtit mund të përfitojnë masa të kuponëve deri në 10 %.
8. Kuotat sipas komunave dhe shkollave janë të specifikuar në aneksin 1.

Kushtet dhe kriteret për aplikim

9. Të drejtë aplikimi për kuponë për kurse të trajnimit në fushën e teknologjisë informative kanë të gjithë nxënësit maturantë, të cilët i plotësojnë këto kushte:
 - 9.1. Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
 - 9.2. Të jenë nxënës të rregullt në arsimin formal publik në klasën e XII për vitin shkollor 2021/2022.

Kriteret për vlerësim

10. Kriteret për të fituar kuponë për kurse të trajnimit në fushën e Teknologjisë informative:
 - 10.1. Nota mesatare e suksesit nga dëftesa e klasës XI.
11. Aplikuesit në rast të kushteve dhe kriterëve të barabarta mund të përzgjidhen me short në prani të komisionit vlerësues nga MASHTI dhe përfaqësuesve të shkollave përkatëse.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim

12. Aplikacioni plotësohet online në vegzën <https://ekosova.rks-gov.net>
13. Dëftesa e notave për klasën XI
14. Vërtetim nga shkolla se nxënësi është i rregullt në klasën e XII për vitin shkollor 2021/2022
15. Vendimi i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (ish Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale) si dëshmi se nxënësi i përket kategorisë me nevoja të veçanta.
16. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Vendimi i dorëzohet:

1. Kabinetit të Ministrit / MASHTI;
2. Zyrës së Sekretarit të përgjithshëm/MASHTI;
3. DAP/MASHTI;
4. DAAP/MASHTI;
5. Arkivit /MASHTI


Arbërie Nagavci

Ministre e MASHTI